



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE			
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIA ARCHIVA-ARCHIVE OFFICE			
Niveli Org. Org. Unit	01	Nr. Prot. Prot. No.	211
Nr. e Dokumentit Doc. Number	02	Data Date	13.11.2012

Nr. prot 87/2012  
Datë: 13.11.2012

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010) mbikëqyrësi kryesor shtetëror merr këtë:

### V E N D I M

1. Këshillohet Kolegji 'UNIVERSUM' të marrë vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.
2. Kolegji 'UNIVERSUM' në afat prej 15 ditësh të njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

### Arsyetim

Në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 (paragrafi 1, 1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejshëm LMDHP), më datë 05.11.2012, Agjencia ka realizuar kontrollin sipas detyrës zyrtare në Kolegjin 'UNIVERSUM'.

Pas kontrollit është përpiluar procesverbali me nr.12/2012, i cili është nënshkruar nga personi përgjegjës dhe të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të kontrollit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Gjatë kontrollit që është bërë në Kolegjin 'UNIVERSUM' është konstatuar se është instaluar sistemi i vëzhgimit me kamerë, janë të vendosura 9 kamera vëzhguese, nuk është nxjerrë akti i brendshëm (vendimi) për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.

Në nenin 62 (paragrafi 1) thuhet se personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre, nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë. Vëzhgimi me kamerë, në veçanti, mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose aty ku, për shkak të natyrës së punës së tyre, ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve.

Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë – Kosovë

Në nenin 62 (paragrafi 2 dhe 3) të LMDHP thuhet që vendimet e nevojshme merren nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori publik ose privat. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemeve të vëzhgimit me kamerë.

Siç është përshkruar në arsyetimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësi kryesor shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë, por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Ruzhdi Jashari

Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit 'UNIVERSUM'
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë

